VENDIM
Nr. 119, datë 11.5.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA, NË CILËSINË E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN PRILL 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 68/9 prot., datë 7.5.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2021",

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 5020 prot., datë 6.5.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për muajin prill 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Bazuar në kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, "Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021" është 0.75 lekë/kwh.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s, "Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit për vitin 2021", është 1.5 lekë/kwh.
- Sasia e energjisë elektrike e prokuruar në treg të parregulluar dhe nga burimet e rinovueshme është 1,554 mwh.
- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", të rishikuar, llogaritjet e shoqërisë FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Prill 2021

	Prill 2021		**Aplikimi FSHU sh.a.**	**Përllogaritjet e ERE**
		Njësia	**Çmimi**	**Çmimi**
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.343	6.343
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.19	0.19
	Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante	Leke/kWh	6.53	6.53
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
	Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA	**Leke/kWh**	**10.57**	**10.57**

- Për sa përcaktohet për çdo element të formulës përllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria FSHU sh.a., furnizuesi i tregut të lirë, si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2021, të jetë 10.57 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga shoqëria FSHU sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit prej 10.57 lekësh/kwh, për muajin prill 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti